



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primjeto Me/Dana 20.05.2013			
Nr. l organit Org. broj	Numri/Broj	Shitje Prilog	Vlera Vrednost
01-013/424			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 36 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 14.05.2013, aprovon këtë:

V E N D I M

SHFUQIZIMIN E VENDIMIT PËR BARTJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË PALUAJTSHMËRISË (TOKË) NË PRONËSI SHOQËRORE PRONË E KOMUNËS SË VITISË NË SHFRYTËZIM TË PËRKOHSHËM BASHKËSISË ISLAME NË VITI – PËR ÇERDHEN E FËMIJËVE NË FSHATIN DROBESH

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, SHFUQIZON Vendimin për bartjen administrative e të drejtës së shfrytëzimit të përkohshëm të pasurisë së pa luajtshme (tokë) e cila evidentohet në emër të titullarit pasuri e P.SH. Shkolla Filllore “Dëshmorët e Vitisë” në Viti, në bartësin e ri në shfrytëzim të përkohshëm Bashkësia Islame në Viti – Çerdhja e fëmijëve në fshatin Drobesh numër 01/13-220 të datës 14.03.2013.

Neni 2

Zyra ligjore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në Prishtinë me shkresën nr 02-04-333 të datës 27.04.2013, ka kërkuar nga Kryesuesi i Kuvendit që Kuvendi i Komunës së Vitisë ta rishqyrtoj ligjshmërinë e Vendimit nr 01-013-220 të datës 14.03.2013 dhe të merret vendim në pajtim me rekomandimet e MAPL-së dhe Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Neni 3

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, konsiderohet se Vendimi numër 01/13-220 i datës 14.03.2013 është inekzistent dhe nuk prodhon efekte juridike.


Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit,
2. Drejtorisë për Kadastër dhe
3. Arkivit



KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibi